



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0742**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani - Kryetar, Agon Ramadani dhe Vedat Poterqoi - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së OE ISUF MUSLIU B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime me ushqim ( furnizim, përgatitje dhe servim) për nevoja të PK-së” me numër të prokurimit 214-23-6749-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 10/11/2023, mori këtë:

## **Vendim**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa, OE NTP “GLOBAL PARAJSA” - Vushtrri me nr. 2023/0742, e datës 29/09/2023, dhe vërtetohet vendimi i AK “Policia e Kosovës” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) për nevojat e PK-së” me numër të prokurimit 214-23-6749-2-1-1.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 07.07.2023, “Policia e Kosovës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) për nevojat e PK-së”. Ndërsa me datën 12.09.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Beni Dona Plast” SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 5,500,000.00 €.

Me 18.09.2023, OE NTP "GLOBAL PARAJSJA" - Vushtrri ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 19.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.09.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE NTP "GLOBAL PARAJSJA" - Vushtrri me nr. 742/23 për lidhur me aktivitetin "Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) për nevojat e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-6749-2-1-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara sipas nenit 111 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP) dhe se ankesa është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin, 109 paragrafin 1 të LPP, pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit, 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit, 4 paragrafit 1, nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit, 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Ankesa e Operatorit Ekonomik NTP "GLOBAL PARAJSJA-Vushtrri*

Operatori Ekonomik ankues, NTP "GLOBAL PARAJSJA-Vushtrri në ankesën e tij pohon si në vijim" ... Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores Nr. OI/2022 për Prokurim Publik sepse nuk ka analizuar çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, madje as nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga ky operator ekonomik. Neni 61.1 e përcakton qartë: Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit (Ihe (ü) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni. Pra autoriteti kontraktues nuk ka ndjek asnjë procedurë ligjore në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë. Siç shihet nga analiza e çmimeve rezulton se për pako të ndryshme ka ofertuar me çmime më të ulëta 118 0/0, 87%, 68 0/0, 48 0/0, 47 0/0, 45 0/0, 44% etj. Është e çuditshme se përse nuk janë kërkuar sqarime dhe nuk janë analizuar çmimet e pakove por në mënyrë të njëanshme autoriteti kontraktues ka favorizuar OE e rekomanduar për kontratë. Sa duhet të jetë çmimi më i ulët e që për autoritetin kontraktues të konsiderohet çmim jo normalisht i ulët? apo të kërkohen sqarime! Nuk ka asnjë mundësi praktike e as ligjore që ky Operator ekonomik ta implementojë këtë kontratë me këto çmime.

Është shqetësuese se si autoriteti kontraktues nuk ka shpreh fare vullnet për të analizuar këto çmime por e kanë rekomanduar për kontratë një OE që shihet qartë dhe dukshëm që ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta. Po ashtu anëtarët e komisionit vlerësues nuk janë asnjën profesional sa i përket çmimeve dhe përgatitjes së ushqimeve, prandaj edhe raporti i vlerësimit nuk është profesional dhe nuk është dashur të merret parasysh nga zyrtari përgjegjës i prokurimit. Komisioni i vlerësimit është dashur të merr parasysh vlerat e parashikuara për pako

ushqimore dhe çmimet e ofruara për pako nga OE i rekomanduar për kontratë. Po ashtu është dashur të kenë parasysh edhe çmimet e tregut dhe çmimet e ofruara nga tenderët e kaluar nga ky operator ekonomi dhe të krahasojë me çmimet aktuale. Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt. 19.09.2023. Në këtë vendim autoriteti kontraktues vetëm ka përkrahur nenet për të cilat keni pretenduar se janë shkelur pa i arsyetuar ato. Në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta, autoriteti kontraktues ka konsideruar se të gjitha çmimet janë çmime të besueshme dhe se nuk ka asnjë çmim që do të ndikonte negativisht në performancë të implementimit të kësaj kontrate. Autoriteti kontraktues i mbron çmimet sikur të ishte vetë OE i rekomanduar për kontratë apo më mirë të themi mundohet ti arsyetojë edhe më shumë se sa vetë OE i rekomanduar për kontratë. Si nuk mund të ndikojë negativisht çmimi i cili është ofruar për 118 %, 87 %, 78 % etj., në krahasim me analizën e çmimeve të bëra nga autoriteti kontraktues, e leje më që këto çmime janë edhe më shumë të ulëta (në përqindje) se sa çmimet aktuale të tregut. Kërkojmë nga eksperti i OSHP-së që të analizojë fillimisht çmimet që i ka nxjerr dhe parashikuar vetë autoriteti kontraktues, më pastaj çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë për pako dhe të analizohen çmimet e tregut për të pasur një pasqyrë të qartë në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Nga ana e autoritetit kontraktues nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm, që ka ofruar çmime JO normalisht të ulëta. Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. PO ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Duke pasur parasysh të gjitha arsyet faktike dhe ligjore që u përmenden më lartë, kërkojmë nga OSHP të merr vendim të aprovohet si e bazuar ankesa e NTP “GLOBAL PARAJSA-Vushtrri dhe të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se (B58) dhe lënda të kthehet në rivlerësim”

*Raporti i ekspertit shqyrtues i datës 17.10.2023*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 04/10/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 742/23, ndërsa me datë 17/10/2023 është dorëzuar raporti i

ekspertit me nr. 2023/0742, si në vijim;

“Aktiviteti i prokurimit “Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) për nevoja të PK-se” me nr. të prokurimit: "214-23-6749-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 03.07.2023, me procedurë të hapur, hapja e ofertave është bërë me datë 04.08.2023, si dhe vendimi mbi rekomandimin është publikuar me datë 14.09.2023. OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 28.09.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, duke pretenduar se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret, si dhe AK nuk ka vlerësuar ofertat konform nenit 1, 7, 59, 60, 61, 69, të LPP-së si dhe neni 40 dhe 41 i Rregullores nr.01/2022 për Prokurim Publik.” OE ankuesi nga AK është shpallur i pasuksesshëm. Tutje, i njëjti pretendon se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta përkatësisht për pakot me nr.5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, dhe 20. Ekspertja shqyrtuesegjatë analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit, duke i krahasuar me dokumentet në e-prokurim, që të mbetet sa më objektiv, ka kërkuar sqarime me e-mail me datë 12.10.2023 nga OE ankuesi lidhur me dëshmitë dhe faktet. OE ankuesi ka bashkangjitur në e-mail dëshmitë (listën) për të cilat AK-njësia kërkuese ka parashikuar një çmimore të pakove, e cila i është dërguar në e-mail ofertuesve si mostër lidhur me parashikimin e çmimeve. Tutje, ekspertja shqyrtuese duke marrë parasysh dëshmitë dhe faktet e OE ankuesit lidhur me çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar, konsideron se AK duhet të kthejë lëndën në rivlerësim, duke kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar, për faktin se AK ka parashikuar një çmimore për ofertuesit e cila bie ndesh me çmimet e OE të rekomanduarit, dhe si rrjedhojë konform nenit 61 të LPP-së gjegjësisht nenit 41, par:41.6, 41.7, 41.8, 41.9, 41.10, 41.11 të udhëzuesit me nr. 002/2023 për prokurim publik, lënda kthehet në rivlerësim dhe rekomandohet AK-në që procesin e rivlerësimit të bëjë konform dispozitave ligjore të LPP-së, udhëzuesit nr. 001/2023 për PP si dhe rregullorja nr. 002/2023 për PP. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues q137 ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar pretendimet e operatorit ekonomik ankues NTP “GLOBAL PARAJSA” - Vushtrri. Argumentimi në raportin e ekspertit është i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues NTP “GLOBAL PARAJSA” - Vushtrri janë të bazuara.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale OE deklaron se pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues”.

*Përgjigje e AK- Policia e Kosovës, nëRaportin e ekspertit shqyrtues.*

Autoriteti Kontraktues-Polica e Kosovës më datën, 18.10.2023, paraqet përgjigje me shkrim lidhur me Raporti i ekspertit shqyrtues të datës 17.10.2023, si në vijim” Policia e Kosovës kundërshton fuqishme dhe nuk pajtohet me mendimin e ekspertës shqyrtuese pasi që nuk ka bërë një shqyrtim të drejtë të ankese, pretendimeve ankimore për aktivitetin e prokurimit; “ Shërbimet e Ushqimit ( furnizim, përgatitje servim ) për nevoja të PK numër të prokurimit 214/23/6749/211 .

E njoftojmë ekspertën shqyrtuese se Autoriteti Kontraktues Polica e Kosovës ka trajtuar në harmoni të plote me LPP-ne Rregulloren Nr.001/2022 këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues nuk e ka konsideruar ofertën e OE të rekomanduar për kontratë me çmime Jo normalisht të ulët.

Konstatimi që ekspertja ka paraqitur në raport ku thotë : “ OE ankues ka bashkëngjitur në e-mail dëshmitë ( listën ) për të cilat AK – njësi kërkues ka parashikuar një çmimore të pakove të ushqimit, e cila i është dërguar në e-mail OFERTUSVE SI MOSTER lidhur me parashikimin e çmimeve. Ky konstatim nuk qëndron pasi që të gjitha ofertat dhe komunikimet behën përmes sistemit të E- prokurimit. Autoriteti kontraktues për çdo inicim të aktivitetit të prokurimit bene hulumtim të tregut, duke u bazuar në kontratë paraprake, hulumtim të tregut në kohën e inicimit dhe mbi këtë hulumtim planifikohen çmime për njësi për secilin artikull dhe nga e cila rrjedh edhe vlera e parashikuar e kontratës. Ky konstatim që ekspertja shqyrtuese ka paraqitur në raport nuk qëndron dhe AK kërkon nga OSHP që të trajtojë në seancë përfundimtare ky konstatim, pasi që Autoriteti Kontraktues Polica e Kosove nuk ka bërë asnjë komunikim jashtë sistemi të E-prokurimit ashtu siç pretendon Ekspertja përmes e-mailave.

Sipas RRUOPP-se Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët paragrafi 41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës. Autoriteti nuk ka konsideruar asnjë çmim të ofertës financiare të OE të rekomanduar për kontratë si jo Normalisht të ULET andaj edhe nuk është aplikuar ky nen për të cilin ju Rekomandoni AK të aplikohet neni 61 i LPP neni 41 paragrafi 41.6, 41.7, 41.8,41.9,41.10,41.11 të RRUOPP-se. Është përgjegjësi e AK të vlerësojë një çmim jo normalisht të ulët.

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera ( nuk ka arsyeje tjera qe Autoriteti Kontraktues Polica e Kosovë për te trajtuar si tender Jo normalisht te ulet) nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

Autoriteti nuk ka konsideruar asnjë çmime te ofertës financiare te OE te rekomanduar për kontrate si jo Normalisht te ULET andaj edhe nuk është aplikuar ky nen për te cilin ju pretendoni te aplikohet. Është përgjegjësi e AK te vlerësoj një çmime jo normalisht te ulet.”

1.Tabela e krahasimeve të çmimeve, AK si ne vijim:

Fshimi i kategorive									
	A								
	5.500.000		40%					3.300.000.00	
	5.500.000		30%					1.650.000.00	
	5.500.000		10%					550.000.00	

  

Lista e përbërësimit të çmimeve									
Fjese A 00 00									
Pako	AK	Globali	Emi Dona	Vlera per pako	Emi Dona	Globali	Ndryshimi ne sasi te pakov	Diferenca ne Euro	
Pako 1	6.88	6.80	6.39	412,500.00	64,553.99	60,661.76	3,892.23		24,871.32
Pako 2	4.90	4.80	4.40	412,500.00	93,750.00	85,937.50	7,812.50		34,375.00
Pako 3	5.50	5.40	5.40	412,500.00	76,388.89	76,388.89	-		-
Pako 5	6.94	6.49	4.20	412,500.00	98,214.29	63,559.32	34,654.96		145,530.85
Pako 8	7.71	7.50	5.90	412,500.00	69,915.25	55,000.00	14,915.25		88,000.00
Pako 9	6.41	6.30	4.20	412,500.00	98,214.29	65,476.19	32,738.10		117,500.00
Pako 13	7.68	7.45	5.50	412,500.00	75,000.00	55,369.13	19,630.87		107,969.80
Pako 15	6.88	6.80	4.75	412,500.00	86,842.11	60,661.76	26,180.34		124,356.62
<b>TOTALI</b>	<b>52.9</b>	<b>51.54</b>	<b>40.74</b>	<b>3,300,000.00</b>	<b>662,878.81</b>	<b>523,054.56</b>	<b>139,824.25</b>		<b>662,623.59</b>

  

Lista e përbërësimit të çmimeve									
Fjese B 30 00									
Pako	AK	Globali	Emi Dona	Vlera per pako	Emi Dona	Globali	Ndryshimi ne sasi te pakov	Diferenca ne Euro	
Pako 4	6.2	6.05	5.9	235,714.29	39,951.29	38,961.04	990.25		5,841.16
Pako 6	7.54	7.4	4.5	235,714.29	52,380.95	31,853.28	20,527.67		92,374.52
Pako 7	6.81	6.7	4.75	235,714.29	49,634.06	35,181.24	14,442.82		68,609.41
Pako 10	7.61	7.5	5.49	235,714.29	42,935.21	31,428.57	11,506.64		63,171.43
Pako 11	7.51	7.3	4.47	235,714.29	52,732.50	32,289.63	20,442.87		91,379.65
Pako 12	6.31	6.2	4.65	235,714.29	50,691.25	38,018.43	12,672.81		58,928.57
Pako 16	7.08	6.95	4.76	235,714.29	49,519.81	33,915.73	15,604.08		74,275.44
<b>TOTALI</b>	<b>49.00</b>	<b>48.1</b>	<b>34.52</b>	<b>1,050,000.03</b>	<b>337,835.35</b>	<b>241,647.92</b>	<b>96,187.43</b>		<b>454,577.18</b>

  

Lista e përbërësimit të çmimeve									
Fjese C 20 te 550.000€ 210.000€									
Pako	AK	Globali	Emi Dona	Vlera per pako	Emi Dona	Globali	Ndryshimi ne sasi te pakov	Diferenca ne Euro	
Pako 14	6.98	6.9	4.16	110,000.00	26,442.3	15,942.0	10,500.28		43,681.16
Pako 17	5.76	5.5	3.5	110,000.00	31,428.6	20,000.0	11,428.57		40,000.00
Pako 18	6.66	6.4	3.56	110,000.00	30,898.9	17,187.5	13,711.38		48,812.50
Pako 19	3.7	3.65	1.7	110,000.00	64,705.9	30,137.0	34,568.90		58,767.12
Pako 20	3.2	3.15	1.7	110,000.00	64,705.9	34,920.6	29,785.25		50,634.92
<b>TOTALI</b>	<b>20.3</b>	<b>25.0</b>	<b>14.02</b>	<b>550,000.00</b>	<b>218,181.52</b>	<b>118,187.15</b>	<b>99,994.37</b>		<b>241,895.70</b>

  

							<b>totali i ndryshimit ne sasi e pakov</b>	<b>totali ne vlera financiare per keto pako</b>
							336,006.06	1,359,096.47

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

*Lidhur me pretendimet e ankuesit:*

*-Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Paneli shqyrtues vrenë se në dosjen tenderit të AK –Policia e Kosovës, me nr.214-23-67492-1-1, të datës ,03.07.2023,i ka caktuar procedurat e tenderit, kushtet kontraktuese dhe dokumentet e nevojshme të cilat janë të nevojshme për aplikim të tenderuesve, e që ishte publik dhe transparente për të gjithë ofertuesit e interesuar. Nuk kemi vërejtur se OE i rekomanduar ka pasur kushte të tjera të sipas FDT, por se ato ishin të njëjta. Ankuesi nuk ka paraqitur se cila është baza dalluese e diskriminimit, e po ashtu nuk ka paraqit asnjë provë të vetme për të dëshmuar pretendimin e diskriminimit të tij nga AK, por vetëm e ka cituar nenin 7 të LPP-së. Paneli shqyrtues këtë pretendim i tij për diskriminim e konstaton si të pabazuar, në mungesë të argumenteve dhe fakteve relevante.

*-Neni 59, i LPP, se anëtarët e komisionit vlerësues nuk janë asnjë profesional sa i përket çmimeve dhe përgatitjes së ushqimeve, prandaj edhe raporti i vlerësimit nuk është profesional dhe nuk është dashur të merret parasysh nga zyrtari përgjegjës i prokurimit. Është shqetësuese se si autoriteti kontraktues nuk ka shpreh fare vullnet për të analizuar këto çmime por e kanë rekomanduar për kontratë një OE që shihet qartë dhe dukshëm që ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta.*

Paneli shqyrtues lidhur me këtë pretendim ankimore thekson se sipas nenit 59 të LPP, është në kompetencën dhe përgjegjësin ligjore të autoriteteve kontraktues të themeloi Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, të cilët njëherit marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e ofertës.

Po ashtu Paneli konstaton se nuk është në përgjegjësin dhe mandatin ligjor të Panelit, të vlerësoj kompetencën dhe profesionalizimin e anëtareve të komisioneve të ndryshme të cilat i themelojnë autoritete kontraktuese, andaj ankesa është e pabazuar, pasi tejkalon autorizimet ligjore të Panelit.

Paneli po ashtu lidhur me pohimin ankimor për mos analizim të çmimeve, vrene se, AK në përgjigjen e tij të datës 17.10.2023, thekson se për çdo inicim të aktivitetit të prokurimit bën

hulumtim te tregut, duke u bazuar ne kontrata paraprake, hulumtim te tregut ne kohen e inicimit dhe mbi ketë hulumtim planifikohen çmime për njësi për secilin artikull dhe nga e cila rrjedh edhe vlere e parashikuar e kontratës, e po AK ashtu përmes një tabele ka paraqitur krahasimet e çmimeve ne mes dy ofertuesve sipas pakove dhe në shumen totale, sipas se cilës ka përzgjedhur ofertuesin me çmim me te ulte të ofertës për 32%., për më shume shih ne faqen 7, Tabela e krahasimeve të çmimeve, AK, andaj dhe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Po ashtu sipas LPP-së, në rastet e çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.

*- Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores Nr. OI/2022 për Prokurim Publik sepse nuk ka analizuar çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, madje as nuk ka kërkuar sqarime shitesë nga ky operator ekonomik.*

Paneli shqyrtues nisur nga faktin në vlerën e tenderit me procedurë të hapur dhe rekomandimin për kontratën me OE, me vlere Normalisht të Ulte të çmimit, sipas nenit 61 te LPP, përcaktohet se nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues mund kërkoj shpjegime dhe informacione nga tenderuesi dhe kjo mbete ne vlerësimin bindjen dhe përgjegjësit ligjore te vlerësimit te çmimit.

Paneli sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi ka kërkuar nga AK “Policia e Kosovës”, sipas autorizimeve ligjore te caktuara ne nenin 63. pika 1.2.3 te LPP, që nga OE, të kërkojnë garancinë për sigurimin e ekzekutimit të kontratës së shërbimeve, në rast të shkeljes së kontratës nga OE.

*Raporti i ekspertit shqyrtues i datës 17.10.2023*

Paneli shqyrtues me kujdese e ka analizuar raportin e ekspertit shqyrtues, i cili në pjesën me të madhe e përfshin pretendimet ankimore të OE, lidhur me pohimet e tija për shkeljet e dispozitave ligjore nga ana e AK. Pjesa kryesore e pretendimit ankimore ka te bëjnë me ofertën e çmimeve më të ulëta të ofruara nga OE i rekomanduar. Paneli vëren se e ekspertizës i mungon një elaborim krahasues në mes çmimeve të ofruara nga të dy operatorët, i cili me pastaj do sjellte të vlerësimi, se sa realisht në shifra është çmimi me i ulet në mes këtyre operatorëve, për të mundur me vlerësuar se a kemi vlere të larta dhe jo relevante për këto shërbime. Po ashtu shumë do ti ndihmonte këtij raporti sikur te behej një hulumtim ne treg, për te marr informacione për vlerën reale ne treg te produkteve me te cilët kane aplikuar OE, për të krijuar një pasqyre me reale të vlerësimit të pretendimeve ankimore.

Paneli shqyrtues pas analizimit të fakteve dhe informacioneve te cilat i përmban kjo prove e vlerëson si të pamjaftueshme, pasi nuk përmban fakte të mjaftueshme lidhur me çështjen e pohimeve ankimore “çmime të ulëta dhe jo te tregut” dhe kjo ka rezultuar ne nxjerrjen e rekomandimit i cili nuk përkon me situatën e këtij procesi ekonomik, andaj dhe përfundimisht Paneli nuk mund ta marr si një fakt të mirëqene dhe nuk ja falë besimin e provës ne ketë çështje administrative.



*AK- Policia e Kosovës, përgjigje në Raportin e ekspertit shqyrtues.*

Paneli shqyrtues e ka analizuar përgjigjen e AK- Policia e Kosovës, e cila e kundërshton konstatimet përkatësisht të gjeturat në raportin e ekspertit shqyrtues. AK thekson të gjitha ofertat dhe komunikimet me OE, behën përmes sistemit të E- prokurimit dhe nuk ka bërë asnjë komunikim jashtë sistemi të E- prokurimit ashtu siç pretendon Ekspertja përmes e-mailave. Po ashtu AK në përgjigje jep sqarimet se për çdo inicim të aktivitetit të prokurimit bene hulumtim të tregut, duke u bazuar në kontrata paraprake, hulumtim të tregut në kohën e inicimit dhe mbi këtë hulumtim planifikohen çmime për njësi për secilin artikull dhe nga e cila rrjedh edhe vlera e parashikuar e kontratës dhe nuk e konsideron ofertën e OE të rekomanduar për kontratë me çmime jo normalisht të ulët. Autoriteti Kontraktues Polica e Kosovës në fund thekson se këtë aktivitet të prokurimit ka trajtuar në harmoni të plotë me LPP-në Rregulloren Nr.001/2022.

Paneli shqyrtues pas analizimit të përgjigjes të AK-Policia e Kosovës, në raportin e ekspertit shqyrtues verën se janë dhënë sqarime të detajuara e të bazuara në ligj dhe rregullore, në kundërshtimin e këtij raporti, që dëshmojnë se provat mbi të cilat është ndërtuar raporti janë të pamjaftueshme dhe kjo ka rezultuar në nxjerrjen e rekomandimit, i cili nuk përkon me situatën e këtij procesi ekonomik. Andaj Paneli shqyrtues e vlerëson si të bazuar dhe fakt të mirëqenë, kundërshtimin e AK-së në këtë çështje administrative.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit një nga një si janë shkruar më lartë. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) për nevojat e PK-së” me numër të prokurimit 214-23-6749-2-1-1.

Paneli shqyrtues rikujton se pretendimet lidhur me çmime ab-normalisht të ulëta, të ngritur nga OE, thekson se qëllimi primar i hartimit të legjislacionit që përkufizon dhe përcakton procedurat e çmimeve jo-normalisht të ulëta është devijimi i mundësive të manipulimit të çmimeve përmes ofertave jo-korrekte me çmime jo të tregut, kështu si pasojë duke mundësuar diskriminimin e OE-ve të cilët konkurrojnë me çmime tregu e të tilla të zakonshme, gjë që nga praktika e deritanishme këto çështje janë hasur tek kontratat kornizë, e sidomos kur sasi të indikative nuk janë të ditura dhe ofertohet me sasi 1 për secilin pozicion, me poentim dhe peshim të çmimeve ku caktohet pesha e vlerësimit të tenderit, etj.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në të dhënat e këtij aktiviteti, të llojit të procedurës së hapur, konstaton se veprimet e ndërmarra dhe sqarimet e ofruara lidhur me këtë, OE ankues nuk ka ofruar dëshmi argumente dhe të dhëna konkrete që dërgojnë të vërtetimi i pretendimit apo klasifikimin e tij si i bazuar, ndërsa mbetet në diskrecion e AK-së (sipas dispozitave të LPP-së) që në këtë rast, duke pasur parasysh instrumentet ligjore që mund të përdorë para dhe përgjatë implementimit të kontratës, siç janë rritja e sigurimit të ekzekutimit, menaxhimi i saj sipas kriterëve standardeve dhe sasive të përcaktuara paraprakisht, e po ashtu bazuar në çmimet e ofertuara të krijuara bindjen se oferta e OE të rekomanduar nuk ka hapësirë manipulimesh si dhe

krijim të vështirësive në implementim të kontratës.

Panali rikujton se të gjitha autoritetet publike, zyrtarët që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të ligjit.

Po ashtu Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, i LPP-së përcakton se të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Andaj përfundimisht duke u bazuar nga të gjitha që u thanë si më sipër, PSH konstaton se është arritur deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ku në këtë rast OE ankues nuk ka arritur të dëshmojë mjaftueshëm dhe dhe te argumentoj lidhur duke vërtetuar përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar, ndaj të cilit ka ngritur pretendime që sipas panelit nuk kanë orientuar drejt ndonjë vendim-marrje, megjithatë paneli vlerëson se në rast dyshimi nga ana e AK-së lidhur me vështirësitë në implementin e kontratës, AK mund të veprojë duke aplikuar nenin 63, LPP-së, për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, të cilat janë lënë në përgjegjësinë e AK-së që si veprime ligjore që mund ti ndërmerr, në rastet e shkeljes se kontratës nga operatori ekonomik.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - ISUF MUSLIU B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: